

FJALA E DEPUTETIT VULLNET SINAJ

E ENJTE 31 MARS 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Mendoj se përgjegjësia ime për të folur sot për këtë akt normativ është më shumë sesa e një deputeti të Partisë Socialiste, e një përfaqësuesi të qarkut të Vlorës apo e një deputeti të Kuvendit. Nga pozicioni i mëparshëm që kam pasur dhe nga biznesi, ndiej një përgjegjësi tjetër për furnizimin e dyqaneve dhe supermarketeve në Shqipëri, atë të ardhjes në ndihmë të popullatës në Shqipëri për të mos munguar asnjë produkt ushqimor. Nën këtë përgjegjësi dua t'i falënderoj të gjithë importuesit shqiptarë dhe bizneset e vogla, që kanë mundur ta sfidojnë krizën, duke mos pasur probleme dhe mungesa në produktet bazë për popullin, kur dihet që edhe vendet e mëdha sot i kanë raftet bosh me produkte të vajit apo të miellit!

Njëkohësisht, dua të them se të gjitha bizneset që falënderova janë duke marrë masa për të vazhduar prezencën e stokut të mallrave të tyre në ndihmë të popullatës. Gjithashtu, dua të falënderoj qeverinë dhe Kryeministrin për ndihmën që u dha bizneseve me garancinë sovranë, duke u dhënë mundësi të rrisin stokun e tyre, duke u garantuar që në çdo rast qeveria do të jetë gati për t'i ndihmuar nëse do t'u ngelen produktet, pasi do t'i marrë mbrapsht! Pra, është një garanci më shumë dhe fat i madh për tregun dhe Shqipërinë. Akti normativ që ne do të miratojmë sot vjen si rrjedhojë e një situatë të vështirë, dhe është i domosdoshëm për t'u kaluar sa më shpejt, sepse i plotëson të gjitha kushtet. Ne gjendemi në një situatë krize, të ardhur nga lufta e padrejtë që bën Rusia kundër popullit të Ukrainës, pasi Ukraina ishte tregu më i madh nga ku ne importonim produkte të vajit dhe të grurit.

Kjo situatë e vështirë, kjo krizë në Shqipëri është pasojë e luftës që Rusia bën me Ukrainën. Çfarë ka ky akt normativ në tërësinë e vetë? Qeveria ka analizuar saktë situatën dhe ka nxjerrë një shifër prej 26 miliardë lekësh për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të Shqipërisë për të përballuar këtë situatë. Në këtë analizë është menduar të bëhet një shkurtim i shpenzimeve me 16 miliardë. Në të vërtetë nuk është gjë e mirë të shkurtojmë shpenzimet, sepse do të preken investimet e menduara për të çuar vendin përpara, por më gëzon puna e mirë që ka bërë Ministria e Financave, duke parë performancën e mirë të planit për 2-mujorin e parë për grumbullimin e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, pasi do të ketë rreth 10 miliardë lekë më tepër të ardhura në buxhetin e shtetit në dispozicion të përballimit të situatës së vështirë të tregut.

E falënderoj Ministrinë e Financave dhe qeverinë, sepse e vlerësoj shumë herë më shumë rritjen e të ardhurave përballë një krize sesa shkurtimin e shpenzimeve! Siç tha kolegja Denaj, shkurtimi i shpenzimeve do të prekë investime të ndryshme dhe nuk është ndonjë gjë shumë e madhe, pavarësisht se deputetët e opozitës nuk e përmendën asnjëherë, por vetëm kërkuan gjatë të gjitha fjalimeve që mbajtët këtu. Si do t'i investojë qeveria 26 miliardë? Si do t'i japë në ndihmë të qytetarëve shqiptarë?

Qeveria ka menduar që 20 miliardë t'i çojë në ndihmë të situatës së vështirë të krizës së energjisë elektrike. Ne e dimë që çmimi i tregut të energjisë elektrike sot në Europë shkon 200, 300 dhe 400 euro për megavat, që përkthehet në kosto prej 25, 35, 45 lekësh të rinj për kilovatë për secilin qytetar dhe biznes të vogël, por asnjë qytetar shqiptar nuk është prekur nga kjo ngritje, sepse e paguajnë me 9,7 lekë kilovatin.

Pra, të gjithë diferencën mbi koston që ka marr sot energjia e mban mbi shpatulla qeveria dhe buxheti i vendit tonë, dhe kjo është për t'u falënderuar. Pjesa tjetër e ndihmës që jep qeveria prej 6 miliardë lekësh do të shkojë për paketën e rezistencës sociale, të ndara në 4 miliardë lekë për 576 mijë përfitues që janë pensionistë, familje në skemën e ndihmës ekonomike, persona me aftësi të kufizuara, duke u dhënë mundësinë të përballojnë çmimet e tregut. Ju kam sjellë një shembull. Kontaktova një qytetare të qytetit tim, e cila vjen nga familje në nevojë, dhe i kërkova të bënte një listë me produktet që ble për 1 muaj, për të vënë re në përfundim ndryshimin e çmimeve në treg, për të kuptuar se sa është kostoja që u është rritur qytetarëve për përballimin e kësaj situatë. Zonja e dinte që unë isha deputet dhe vija nga biznesi, prandaj në listën e saj i rriti disa nga çmimet, por unë e kam bërë tabelën me çmimet që kanë qenë në vitin 2021 dhe çmimet që janë sot. Rritja e çmimeve për produktet që i nevojiteshin zonjës në shtëpinë e vet, edhe pse i ka rritur çmimet, nuk i kalojnë 2 mijë lekë të rinj. Zonja blinte 25 kilogram miell dhe e bënte bukën vetë, sepse energjia elektrike nuk kushton shumë. Këto çmime nuk i vendosa unë për të bërë propagandë politike, por ia lash zonjës të drejtën. Ky është realiteti.

Të mos themi se 3 mijë lekë të rinj që qeveria ka akorduar për njerëzit në nevojë është pak. Për momentin i plotëson nevojat. Kërkesat janë të pafundme dhe gjithkush kërkon më shumë, por kjo ndihmë jepet në këtë situatë të vështirë që po kalon vendi. Për t'u kthyer sërish tek akti normativ, janë 1 miliardë lekë për 673 mijë e 542 pensionistë indeksim i pensioneve, 500 milionë lekë në mbështetje të sektorit të transportit publik për të mos u rritur bileta, 500 milionë lekë që bujqësia të marrë naftën falas, që është gjë shumë e mirë, sepse e dimë që në situatën ku jemi, përballë vështirësisë për produktet bazë si gruri, kjo është ndihmë shumë e mirë nga ana e qeverisë. Po kështu, në aktin normativ që do të kalojmë më vonë, kemi heqjen e tatimit për pagat e punonjësve deri në 40 mijë lekë dhe përgjysmimin e tatimit për pagat 40-50 mijë lekë të rinj. Kjo është, gjithashtu, një ndihmë që qeveria u jep qytetarëve. Nga ana tjetër, qeveria ka nxjerrë një vendim më 12 mars 2022 për ta çuar pagën minimale në 32 mijë lekë të rinj nga 30 mijë lekë të rinj.

Të nderuar kolegë të opozitës,

Dëgjova fjalimet e deputetëve dhe ish-ministrave, ndërkohë po mendoja se si ka qenë Shqipëria në kohën e drejtuar nga Partia Demokratike dhe sa ka qenë paga minimale në atë kohë. Çuditërisht, nga të dhënat që pashë, 20 mijë lekë të rinj ka qenë paga minimale e punëtorit në vitin 2013, ndërsa sot është 32 mijë lekë. Pra, një rritje mbi 50% e pagës minimale. Nuk është gjë e madhe, por është shumë duke e krahasuar me ekonominë tonë. Në fund të mandatit do të shkojmë në 38-40 mijë lekë të rinj, pra në dyfishim të pagës minimale brenda mandateve të Partisë Socialiste. Ne kemi ndryshime të mëdha në ide, por ju konceptoni ndryshe dhe pyesni: pse nuk ulen taksat e naftës? Kolegia më parë tha: "I keni vendosur vetë ato taksa dhe i paskeni vendosur drejt. Pse nuk ulet TVSH-ja për produktet ushqimore"?

Të nderuar kolegë,

Sot, në këtë kohë nuk është momenti, sepse jo vetëm Shqipëria apo Europa, por po zien e gjithë bota. Në këtë kohë qeveria jonë ka zgjedhur të mbledhë taksat tuaja, të miat, tonat, nga nafta që ne harxhojmë, dhe t'ua japë sektorëve dhe njerëzve që kanë nevojë. Unë prisja që sot dikush nga ju, deputetë të opozitës, të jepte një shembull personal duke thënë: unë do të bëj këtë gjë në të mirë të banorëve të zonës sime, por nuk e dëgjova. Unë dua t'ju them se veç debateve dhe problematikave që ngrini, bashkohuni me ne, bashkohuni me qeverisë, siç janë bashkuar të gjithë shqiptarët, siç është bashkuar edhe biznesi, që e ka kuptuar shumë mirë situatën! Bashkohuni edhe ju, të nderuar kolegë deputetë të opozitës për të dhënë kontributin tuaj në këtë situatë të jashtëzakonshme për t'ua lehtësuar sa më shumë këtë situatë familjeve shqiptare! Do t'ju ftoja që bashkë me ne ta votoni edhe ju këtë akt normativ. Faleminderit!